


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori III, 2023

Tiranë, më 11 Dhjetor 2023: Në tremujorin e tretë të vitit 2023, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 131,2 kundrejt vitit 2020. Krahasuar me tremujorin e tretë 2022 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit shënoi një rritje me 5,2 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 20,9 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në tremujorin e tretë 2023 shënoi rritje me 0,5 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit



Ndryshimi vjetor : Krahasuar me tremujorin e tretë 2022 rritja më e madhe e çmimeve prej 8,5 % vërehet në seksionin “Industri nxjerrëse”, pasuar nga seksionet, “Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar” me 6,4 %, “Industri përpunuese” me 4,4 % dhe “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 2,0 %. Brenda seksionit “Industri përpunuese” rritja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 19,8 %, pasuar nga aktivitetet “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 11,7 %, “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” me 6,7 %, “Prodhimi i mobileve” me 6,1, “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 5,9 %, etj. Nga ana tjetër ulja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin “Përpunimi i tekstileve” me 5,4 %, pasuar nga “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 5,1 %, “Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë” me 1,9 %, “Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjusmërimorkiove” me 1,1 %, etj.

Për publikim 11/12/2023

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas: Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, indeksi shënoi rritje me 7,2 %. Rritja më e madhe e çmimeve vërehet në seksionin “Industri nxjerrëse” me 13,6 %, pasuar nga seksionet “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 8,6 %, “Industria Përpunuese” me 6,7 % dhe “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,6 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport: Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, indeksi shënoi rritje prej 1,9 %. Rritja më e madhe e çmimeve është shënuar në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 14,0 %, pasuar nga seksioni “Industria Përpunuese” me 1,7 %, “Industri Nxjerrëse” me 0,4 %. Nga ana tjetër seksioni “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” ka shënuar ulje me 0,2 %.

Ndryshimi tremujor: Krahasuar me tremujorin e dytë 2023 rritja më e madhe prej 2,1 % vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar”, pasuar nga seksionet “Industri Nxjerrëse” me 0,8 %, “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,1 %. Nga ana tjetër seksioni “Industri Përpunuese” ka shënuar ulje me 0,1 %. Brenda këtij seksioni ulja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetet “Prodhimi i pajisjeve elektrike” me 2,1 %, pasuar nga aktivitetet “Përpunimi i tekstileve” me 1,8 %, “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure” me 1,1 %, etj.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas: Krahasuar me tremujorin e dytë 2023, indeksi shënoi rritje me 0,9 %. Rritja më e madhe vërehet në seksionin “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” me 2,9 %, pasuar nga seksionet “Industri Nxjerrëse” me 0,9 %, “Industria Përpunuese” me 0,2 % dhe “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,1 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport: Krahasuar me tremujorin paraardhës indeksi shënoi ulje me 0,2 %. Seksioni “Industria Përpunuese” shënoi ulje me 0,4 %. Nga ana tjetër, seksioni “Industri Nxjerrëse” shënoi rritje me 0,6 %, pasuar nga seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,1 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2020=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	07-23	08-23	09-23	III-23	III-23 /II-23	III-23/III-22
	Gjithsej	100,0	131,1	131,2	131,3	131,2	0,5	5,2
B	Industri Nxjerrëse	11,3	156,6	156,2	156,1	156,3	0,8	8,5
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	4,4	184,5	184,5	184,5	184,5	2,8	5,5
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,9	156,9	156,2	156,1	156,4	-0,6	10,7
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,9	127,7	127,7	127,7	127,7	0,8	6,3
C	Industri Përpunuese	58,8	124,6	124,9	124,9	124,8	-0,1	4,4
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	8,0	139,8	139,8	139,9	139,9	0,5	11,7
11	Prodhimi i pijeve	1,6	122,3	122,1	122,1	122,2	0,3	5,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,0	102,6	102,6	102,6	102,6	2,0	2,7
13	Përpunimi i tekstileve	0,7	97,6	97,6	97,6	97,6	-1,8	-5,4
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,9	106,7	107,0	107,0	106,9	-0,5	0,9
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	3,9	110,1	109,8	110,1	110,0	-1,1	1,4
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,3	127,3	127,2	128,5	127,7	0,0	4,4
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0,8	114,7	114,7	114,7	114,7	1,0	2,7
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	2,7	125,2	125,3	125,3	125,3	0,6	19,8
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,7	123,2	123,2	123,2	123,2	1,8	-5,1
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,2	131,6	131,7	131,7	131,7	-0,7	2,1
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	1,1	124,5	124,5	124,5	124,5	0,8	0,8
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,4	121,1	121,1	121,0	121,1	0,2	-0,8
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	8,2	141,2	141,5	141,8	141,5	-0,8	5,9
24	Metalurgjia	10,2	127,5	128,1	128,0	127,9	0,1	0,7
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,9	135,9	138,2	138,2	137,4	-0,3	6,7
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,3	97,9	97,9	97,9	97,9	-0,8	-1,9
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	1,2	99,3	99,3	99,3	99,3	-2,1	3,1
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,6	102,1	102,1	102,1	102,1	-0,5	0,0
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,4	94,5	94,5	94,5	94,5	-0,4	-1,1
30	Pajisje të tjera transporti	0,1	125,8	125,8	125,8	125,8	0,0	3,7
31	Prodhimi i mobiljeve	5,1	121,5	121,4	120,9	121,3	1,2	6,1
32	Industri të tjera p.k.t	0,3	104,7	104,7	104,7	104,7	1,3	0,2
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	108,1	108,1	108,1	108,1	0,0	3,6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	20,5	151,5	151,5	151,5	151,5	2,1	6,4
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	20,5	151,5	151,5	151,5	151,5	2,1	6,4
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	9,4	105,5	105,3	105,4	105,4	0,1	2,0
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	6,8	100,6	100,6	100,6	100,6	0,0	0,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,7	136,8	136,2	136,6	136,5	0,3	8,7

Tab. 2 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

2020=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	07-23	08-23	09-23	III-23	III-23 / II-23	III-23/III-22
	Gjithsej	100,0	128,7	128,8	128,8	128,8	0,9	7,2
B	Industri Nxjerrëse	9,3	154,1	153,6	153,6	153,8	0,9	13,6
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	2,2	174,8	174,8	174,8	174,8	3,3	16,5
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	6,0	161,8	161,0	161,0	161,2	0,1	14,4
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,1	126,7	126,7	126,7	126,7	0,3	5,3
C	Industri Përpunuese	54,6	133,5	133,7	133,7	133,7	0,2	6,7
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	8,5	146,9	147,0	147,0	147,0	0,2	14,2
11	Prodhimi i pijeve	2,2	122,0	121,7	121,8	121,8	0,3	5,9
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	103,0	103,0	103,0	103,0	2,2	3,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,4	120,8	120,9	120,9	120,9	0,0	1,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	0,1	106,4	106,4	106,4	106,4	-0,5	1,4
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	1,3	112,7	112,7	112,7	112,7	1,7	-2,5
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,4	130,7	130,7	132,6	131,3	0,4	0,9
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0,1	121,0	121,2	121,3	121,2	1,3	2,4
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	4,3	125,2	125,3	125,3	125,3	0,6	19,8
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,2	153,7	153,7	153,7	153,7	0,0	1,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,8	138,0	138,1	138,2	138,1	-0,4	1,5
21	Përpunimi i produkteve farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	1,7	126,0	126,0	126,0	126,0	0,8	0,8
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,4	127,4	127,4	127,3	127,4	-0,9	0,5
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	10,1	138,8	139,2	139,5	139,2	-0,9	7,1
24	Metalurgjia	8,7	139,6	140,6	140,6	140,3	0,5	0,0
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,1	137,7	137,7	137,7	137,7	-0,3	9,5
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,2	95,5	95,5	95,5	95,5	-0,6	-2,3
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,2	99,9	99,9	99,9	99,9	-0,3	-0,1
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t	0,5	109,0	109,0	109,0	109,0	-0,4	-0,1
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0,1	92,6	92,6	92,6	92,6	-0,3	-3,5
30	Pajisje të tjera transporti	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	7,0	121,7	121,6	120,9	121,4	1,6	5,8
32	Industri të tjera p.k.t	0,3	113,1	113,1	113,1	113,1	1,3	6,6
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,2	108,1	108,1	108,1	108,1	0,0	3,6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	22,8	127,1	127,1	127,1	127,1	2,9	8,6
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	22,8	127,1	127,1	127,1	127,1	2,9	8,6
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	13,2	101,2	101,2	101,2	101,2	0,1	0,6
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	10,7	100,6	100,6	100,6	100,6	0,0	0,0
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,6	102,0	102,0	102,0	102,0	0,6	6,9

Tab. 3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

2020=100

NVE	Përshkrimi	Peshat	07-23	08-23	09-23	III-23	III-23/ II-23	III-23/III-22
	Gjithsej	100,0	140,9	141,2	141,2	141,1	-0,2	1,9
B	Industria Nxjerrëse	14,7	163,6	163,3	163,3	163,4	0,6	0,4
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	8,3	185,8	185,8	185,8	185,8	2,5	-3,4
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,8	159,3	158,7	158,5	158,9	-1,7	6,5
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,6	128,7	128,7	128,7	128,7	2,4	10,3
C	Industria Përpunuese	65,9	113,8	114,3	114,3	114,1	-0,4	1,7
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	7,2	121,9	121,9	122,1	122,0	1,0	6,6
11	Prodhimi i pijeve	0,6	126,8	126,8	126,8	126,8	0,0	0,0
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,0	99,0	99,0	99,0	99,0	-0,6	-0,6
13	Përpunimi i tekstileve	1,2	91,1	91,1	91,1	91,1	-2,9	-8,8
14	Konfeksionimi i veshjeve	10,5	106,8	107,2	107,2	107,1	-0,5	0,9
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	8,4	109,8	109,5	109,8	109,7	-1,9	1,6
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,1	123,5	123,4	123,4	123,4	-0,8	8,4
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	2,2	113,8	113,8	113,8	113,8	1,0	3,1
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,5	121,4	121,4	121,4	121,4	2,3	-5,5
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,9	124,0	124,0	124,0	124,0	-1,0	4,1
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,1	105,6	105,6	105,6	105,6	0,0	1,4
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,3	111,2	111,2	111,2	111,2	2,2	-3,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	4,9	165,6	165,6	165,6	165,6	-0,6	0,4
24	Metalurgjia	12,8	116,2	116,3	116,1	116,2	-0,3	1,7
25	Prodhimi i produkteve metalike të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,7	130,3	136,6	136,5	134,5	-0,2	-0,5
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,7	98,5	98,5	98,5	98,5	-0,8	-2,3
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	3,0	99,1	99,1	99,1	99,1	-2,3	2,9
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t	0,8	101,8	101,8	101,8	101,8	-0,5	0,2
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,8	94,7	94,7	94,7	94,7	-0,4	-0,9
30	Paisje të tjera transporti	0,2	129,1	129,1	129,1	129,1	0,0	4,1
31	Prodhimi i mobiljeve	1,8	122,6	122,6	122,6	122,6	-1,7	8,8
32	Industri të tjera p,k,t	0,4	102,9	102,9	102,9	102,9	1,3	-1,5
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	16,5	401,3	401,3	401,3	401,3	0,0	-0,2
35	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	16,5	401,3	401,3	401,3	401,3	0,0	-0,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,9	166,5	164,5	165,8	165,6	0,1	14,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,9	166,5	164,5	165,8	165,6	0,1	14,0

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri nxjerrëse

Seksioni C – Industri përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar

Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i kampionit të ndërmarrjeve dhe shportës së produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i parë 2021 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2020 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{2020}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=2020}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2020 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2020 (2020 = 100).
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2020 deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.